

Fushatë preventive për institucionalizimin e fëmijëve pa prindër dhe pa kujdes prindëror dhe për promovimin e formave alternative të përkujdesjes.




unicef 




ÇDO FËMIJE


Çdo fëmijë ka të drejtë të rritet në një familje të kujdesshme, e cila i mundëson zhvillim të drejtë. Vetëm ashtu, ai mund t'i zhvillojë potencialet e veta. Varfëria apo pengesat në zhvillim asnjëherë nuk duhet të jenë arsye për ndarje të fëmijës nga familja biologjike dhe strehimin e tij në institucion. Sado i mirë të jetë institucioni për përkujdesjen e fëmijëve, ai megjithatë asnjëherë nuk është më i mirë se familja.


Ekziston mbështetja për familjet, të cilat kanë vështirësi të sigurojnë përkujdesje:


 Mbështetja psiko-sociale dhe kujdesi shtëpiak mund t'ju ndihmojnë fëmijëve dhe familjeve të tyre që t'ia dalin në krye me problemet mentale, fizike, emotive dhe sociale.

 Qendrat ditore ofrojnë mbështetje për fëmijët me nevoja të veçanta dhe për familjet e tyre. Qendrat janë të hapura ditëve të punës dhe sigurojnë aktivitete tetorëshe të cilat përfshijnë terapi dhe nxitje të të mësuarit të fëmijëve si dhe përkrahje rreth kycjes së tyre në shoqëri dhe në mësimin e rregullt nëpër shkolla.

Ka shumë arsye se pse disa fëmijë nuk mund të rriten pranë prindërve të tyre: ndonjëherë për shkak të sëmundjes apo vdekjes së prindërve, por më shpesh për shkak të lënies pas dore nga prindërit apo për shkak të keqtrajtitimit nga ana e prindërve. Vetëm në atmosferë shtëpie fëmija mund të ndiejë përkatësi dhe përkrahje. Ekzistojnë alternativa të përkohshme të cilat ofrojnë atë tip kujdesi deri në përmirësim të gjendjes tek familja biologjike, për ata fëmijë të cilët nuk kanë mundësi të sigurojnë kthim në familjen e tyre deri në momentin e adoptimit të tyre.

 Përkujdesje në familjen më të gjerë biologjike, është një formë e organizuar e kujdesit kur fëmija jeton me gjyshin, gjyshen apo ndonjë kushëri të afërt i cili është i lidhur emocionalisht me fëmijën;

 Shtëpitë e vogla grupore sigurojnë kujdes një grupi të vogël fëmijësh (prej 5-8 fëmijë) në nivel të bashkësisë;

 Familje përkujdesëse, është një formë e organizuar e kujdesit kur fëmija jeton në familje e cila ka të ardhura të mjaftueshme dhe vendbanim, e para së gjithash ka dëshirë që kohën, energjinë dhe ngrohtësinë ta ndajë me fëmijën.

Lajmërohu në Qendrën më të afërt për punë sociale që të njihesh më gjerësisht me shërbimet të cilat ofrojnë mbështetje familjeve apo që të zbulosh se si të rriten të gjithë fëmijët në familje.

Sepse ÇDO FËMIJE I DUHET FAMILJE!



I DUHET FAMILJE!